



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 73

Tiranë – E enjte, 24 prill 2025

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 233, datë 24.4.2025 | Për shpallje ditë zie kombëtare..... 8055                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 234, datë 24.4.2025 | Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të një pjese të pasurisë nr. 77, zona kadastrale 2380, me vendndodhje në Njësinë Administrative Dajt, dhe për një shtesë në vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar..... 8055 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 235, datë 24.4.2025 | Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “ <i>Gemtech Albania</i> ” sh.p.k..... 8058                                                                                                                                                                                                                            |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 236, datë 24.4.2025 | Për pezullimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë..... 8060                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 237, datë 24.4.2025 | Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 8060                                                                                                                                                                                                                  |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 239, datë 24.4.2025 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” ..... 8067                                                                                                                                                                                                                                                                        |

Vendim i Këshillit të Ministrave  
nr. 240, datë 24.4.2025

Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 730, datë  
20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores  
për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e  
strukturave akomoduese”, të ndryshuar.....

8069



## VENDIM

Nr. 233, datë 24.4.2025

**PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare ditën e shtunë, datë 26.4.2025, në shenjë dhimbjeje, respekti e mirënjohjeje për Atin e Shenjtë, Papa Françesku, i cili ndërroi jetë pas një sëmundjeje.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë.

3. Ftohen të gjitha stacionet radiotelevizive, publike dhe private që gjatë ditës së zisë kombëtare të transmetojnë muzikë funebër.

4. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore dhe publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**

## VENDIM

Nr. 234, datë 24.4.2025

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 77, ZONA KADASTRALE 2380, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJT, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 219, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PJESSHME (PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TIRANË, BASHKIA TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të një pjese të pasurisë nr. 77, zona kadastrale 2380, me vendndodhje në njësinë administrative Dajt, sipas formularit dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur për realizimin e funksioneve të shërbimit funeral.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Bashkia Tiranë të plotësojë kushtet teknike, që lidhen me linjën e tensionit të lartë, dopjo qark, L 220-5/6 (Tirana 1 – Elbasan 1) dhe me shtyllën nr. 19, si më poshtë vijon:



a) në bazamentin e shtyllës plus 2 (dy) m të mos kryhen punime;

b) në distancën 6 (gjashtë) m me përcjellësin anësor të linjës të mos ndërtohen objekte shërbimi;

c) të sigurohet rrugë aksesit deri në bazamentin e shtyllës për operimin dhe shfrytëzimin e linjës.

4. Bashkisë Tiranë i ndalohet ndryshimi i destinacionit, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim të

të tretëve të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE  
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

| Bashkia: Tiranë                               |                                  |              |                | Identifikoi: Raif Halidini (Përgjegjës Sektori) #723 Majlinda Metani (Specialist) #6            |                                        |                                                |                                       | Mimoza Leka: Drejtor (Drejtoria e Shpronësimit e Inventarizimit dhe Zhvillimit të Pronës) |                                                            |                                        |  |
|-----------------------------------------------|----------------------------------|--------------|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------------------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|----------------------------------------|--|
| Fusha e përdorimit të Pronës: Shërbim funeral |                                  |              |                | Supervizoi: Alban Dokushi: Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit) |                                        |                                                |                                       | Alban Dokushi: Sekretar i Përgjithshëm (i deleguar)                                       |                                                            |                                        |  |
| Aprovoi: Erion Vellaj (Kryetar)               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |
| Nr. Rend.                                     | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurisë | Lloji i Pronës | Emri i Pronës Adresa                                                                            | Sip. Totale e Pronës (m <sup>2</sup> ) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m <sup>2</sup> ) | Funksioni për të cilin përdoret Prona | Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative                                         | Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit | Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |  |
| 1                                             | 2                                | 3            | 4              | 5                                                                                               | 6                                      | 7                                              | 8                                     | 9                                                                                         | 10                                                         | 11                                     |  |
| 1                                             | 2380 K-34-88- (253-A)            | 77           | Ullishte       | Varreza Fshati Lanabregas, Nj Ad Dajt Bashkia Tiranë                                            | 4200                                   |                                                | Shërbime funerale                     | Bashkia Tiranë                                                                            | Bashkia Tiranë                                             | Vol.2; fq. 145 shtet                   |  |
|                                               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |
|                                               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |
|                                               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |
|                                               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |
|                                               |                                  |              |                |                                                                                                 |                                        |                                                |                                       |                                                                                           |                                                            |                                        |  |





## PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET DATE 22.01.2025 QELIMI: INVENTARIZIM/REGJISTRIM  
 VENDNDODHJA DVASHK/ZVASHK: TIRANË RURALE 1 ZONA KADASTRALE: 2380 NUMRI PASURISE: 77 INDEX HARTE: K-34-88-(253-A)  
 BASHKIA: TIRANË  
 TE DHENAT E PASURISE  
 LLOJI PASURISE: ULLISHTE SIP. PASURISE = 13060 m<sup>2</sup> SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT: \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> NUMRI KATEVE: \_\_\_\_\_ NUMRI PEMEVE: \_\_\_\_\_


X = 490483.02

Y = 4579029.00

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X = 490962.90

Y = 4579029.00



X = 490483.02

Y = 4578694.00

SH 1: 2500

X = 490962.90

Y = 4578694.00

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI       | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|-----|-----------|-----------|--------------|----------------|---------|------------------------|
| 1   | VERI      |           |              | VERI: 77; 66   |         |                        |
| 2   | LINDJE    |           |              | LINDJE: 77; 66 |         |                        |
| 3   | JUG       |           |              | JUG: 77        |         |                        |
| 4   | PERENDIM  |           |              | PERENDIM: 77   |         |                        |

## REALIZOI PER BASHKINE TIRANE:

EMRI: RAIF HALIDINI

INXH. TOPOGRAF

## REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DVASHK

NENSHKRIMI

## KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: TERREN, Z-ZYRE, ORTOFOTO, G-GIPS, S-STACIONTOTAL, D-MATJE DISTANCASH

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT: K-KUFITAR PJESERISHT

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare te Gjithe; KP-Kufitare Pjeserisht;

PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

## SHENIME TE VECANTA:

## KONFIRMOI

DREJTORI I DPJAL: Z. ALBAN DOKUSHI

NENSHKRIMI / VULA

Kode per teknologjinë e matjeve dhe percaktimin e kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare të Gjithë; KP-Kufitare Pjesërisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.



## VENDIM

Nr. 235, datë 24.4.2025

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË  
CENTRALIT GJENERUES TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE  
FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE  
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË  
OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN  
SHEQ MARINAS, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA  
FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA  
“GEMTECH ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “GEMTECH ALBANIA” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “GEMTECH ALBANIA” sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: M02215032T;

c) Tipi i centralit: Fotovoltaike;

ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqëria “GEMTECH ALBANIA” sh.p.k., ka detyrimin që:

i. Të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;

ii. Të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. Të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “GEMTECH ALBANIA” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. T’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy)%, të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. Të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “GEMTECH ALBANIA” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku




## ANEKSI 1

Koordinatat e centralit elektrik fotovoltaik  
në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier  
Shoqëria “GEMTECH ALBANIA”, sh.p.k.

| KRGJSH<br>Parcela1 | E         | N          |
|--------------------|-----------|------------|
| 1                  | 451759.84 | 4517294.02 |
| 2                  | 451900.96 | 4517181.32 |
| 3                  | 451684.08 | 4516915.02 |
| 4                  | 451545.69 | 4517026.03 |

| KRGJSH<br>Parcela 2 | E         | N          |
|---------------------|-----------|------------|
| A                   | 451672.66 | 4517509.95 |
| B                   | 451817.49 | 4517394.17 |
| C                   | 451598.37 | 4517122.28 |
| D                   | 451454.46 | 4517237.88 |





## VENDIM

Nr. 236, datë 24.4.2025

**PËR PEZULLIMIN E MARRËVESHJES,  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË BJELLORUSISË, PËR  
HEQJEN RECIPROKE TË KËRKESAVE  
PËR VIZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Pezullimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë, miratuar me vendimin nr. 152, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave.

2. Vendimi nr. 295, datë 15.5.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e pjesshëm të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bjellorusisë, për heqjen reciproke të kërkesave për vizë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**

## VENDIM

Nr. 237, datë 24.4.2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.  
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË  
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË  
BASHKIMIT EVROPIAN PËR  
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE  
SHFUQIZIMIN E MASAVE  
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,  
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2024/2654 ... “shtohen “... (CFSP) 2025/336, (CFSP) 2025/514.”.

2. Në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2025/336, (CFSP) 2025/514, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Belinda Balluku**



2025/336

19.2.2025

**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2025/336**

i datës 18 Shkurt 2025

**për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Duke qënë se:

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 <sup>(1)</sup>.
- (2) Më 9 dhjetor 2022, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (KSKB) miratoi Rezolutën 2664 (2022). Në atë Rezolutë, KS i OKB-së vendosi që siguri, përpunimi ose pagesa e fondeve, asetëve të tjera financiare ose burimeve ekonomike ose ofrimi i mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për të siguruar shpërndarjen në kohë të ndihmës humanitare ose për të mbështetur aktivitetet të tjera që mbështesin nevojat themelore të njeriut, lejohen dhe nuk janë shkelje e ngrirjes së asetëve të vendosura nga OKB-ja ose Komitetet e saj të Sanksioneve. Në Rezolutën 2664 (2022), KS i OKB-së vendosi gjithashtu që përjashtimi humanitar do të zbatohet për regjimin e sanksioneve të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës për një periudhë prej dy vjetësh nga data e miratimit të asaj rezolute.
- (3) Më 31 mars 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/726 (2), i cili ndryshoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 për të futur përjashtimin humanitar të vendosur nga KS i OKB-së në Rezolutën 2664 (2022), i cili do të zbatohet deri më 9 dhjetor, përveç nëse KS i OKB-së vendos ta zgjasë aplikimin e saj përtej asaj date.
- (4) Më 6 dhjetor 2024, KS i OKB-së miratoi Rezolutën 2761 (2024) dhe vendosi që përjashtimi humanitar i paraqitur me Rezolutën 2664 (2022) duhet të vazhdojë të zbatohet për regjimin e sanksioneve të ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës.
- (5) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Në nenin 6 të Vendimit (CFSP) 2016/1693, paragrafi 2 fshihet.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, 18 shkurt 2025.

Për Këshillin

Presidenti

A. DOMAŇSKI

<sup>(1)</sup> Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i 20 shtatorit 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJL 255, 21.9.2016, f. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2016/1693/oj>).

<sup>(2)</sup> Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/726 i datës 31 mars 2023 që ndryshon disa vendime të Këshillit në lidhje me masat kufizuese me qëllim për të futur dispozita për një përjashtim humanitar (OJ L 94, 3.4.2023, f. 48, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/726/oj>).



2025/336

19.2.2025

## COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/336

of 18 February 2025

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 <sup>(1)</sup>.
- (2) On 9 December 2022, the United Nations Security Council (UNSC) adopted Resolution 2664 (2022). In that Resolution, the UNSC decided that the provision, processing or payment of funds, other financial assets or economic resources or the provision of goods and services necessary to ensure the timely delivery of humanitarian assistance or to support other activities that support basic human needs are permitted and are not a violation of the asset freezes imposed by the UNSC or its Sanctions Committees. In Resolution 2664 (2022), the UNSC also decided that the humanitarian exemption will apply to the ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda sanctions regime for a period of two years from the date of adoption of that Resolution.
- (3) On 31 March 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/726 <sup>(2)</sup>, which amended Decision (CFSP) 2016/1693 to introduce the humanitarian exemption established by the UNSC in Resolution 2664 (2022), which would apply until 9 December 2024, unless the UNSC decided to extend its application beyond that date.
- (4) On 6 December 2024, the UNSC adopted Resolution 2761 (2024) and decided that the humanitarian exemption introduced by Resolution 2664 (2022) should continue to apply to the ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda sanctions regime.
- (5) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

In Article 6 of Decision (CFSP) 2016/1693, paragraph 2 is deleted.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 18 February 2025.

*For the Council*

*The President*

A. DOMAŃSKI

<sup>(1)</sup> Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2016/1693/oj>).

<sup>(2)</sup> Council Decision (CFSP) 2023/726 of 31 March 2023 amending certain Council Decisions concerning restrictive measures in order to insert provisions on a humanitarian exemption (OJ L 94, 3.4.2023, p. 48, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/726/oj>).



2025/514

17.3.2025

## VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2025/514

më 17 mars 2025

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të

Sigurisë, duke pasur parasysh:

- (1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693<sup>(1)</sup>.
- (2) Duke pasur parasysh kërcënimin e vazhdueshëm të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me ta, një entitet duhet t'i shtohet listës së personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2016/1693.
- (3) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar në përputhje me Aneksin e këtij Vendimi.

*Neni 2*

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 17 mars 2025.

*Për Këshillin**Presidenti*

K. KALLAS

<sup>(1)</sup>Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i datës 20 shtator 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me ta dhe shfuqizimi i Pozicionit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJ L 20125, f. ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2016/1693/oj>).



SHQIP

OJ L, 17.3.2025

ANEKSI

Në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2016/1693, hyrja e mëposhtme është shtuar nën titullin 'B. Grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e përmendura në nenin 3':

'7. Fondacioni Mediatik Al-Azaim.'



2025/514

17.3.2025

## COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/514

of 17 March 2025

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 <sup>(1)</sup>.
- (2) In view of the continued threat posed by ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them, one entity should be added to the list of persons, groups, undertakings and entities set out in the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693.
- (3) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

## Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

## Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 17 March 2025.

For the Council

The President

K. KALLAS

<sup>(1)</sup> Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2016/1693/oj>).



EN

OJ L, 17.3.2025

## ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693, the following entry is added under the heading 'B. Groups, undertakings and entities referred to in Article 3':

'7. Al-Azaim Media Foundation.'



## VENDIM

Nr. 239, datë 24.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 119, DATË 1.3.2023,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE  
PËR TRANSPORTIN E PUNONJËSVE  
ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË  
NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË  
VENDBANIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 37, pika 5, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 119, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.”

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), bazuar në informacionin që marrin nga drejtuesit e IAP-ve publike, dërgojnë, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, të dhëna për numrin e fëmijëve/nxënësve dhe të punonjësve arsimorë të tyre, që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, sipas kritereve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore miratojnë, brenda muajit tetor, linjat dhe oraret e transportit rrethqytetës për realizimin e këtij shërbimi në vitin e ardhshëm buxhetor, duke u bazuar në informacionin që u dërgohet nga ZVAP-të dhe ofruesit e arsimit profesional publik sipas kësaj pike.

Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) realizojnë procedurën e prokurimit publik brenda muajit nëntor për vitin e ardhshëm buxhetor, mbështetur në kërkesat zyrtare të dërguara nga ZVAP-të.

Ofruesit e arsimit profesional publik dërgojnë, brenda muajit tetor të çdo viti shkollor, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, listat për numrin e nxënësve dhe të punonjësve arsimorë të tyre, që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, sipas kritereve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për miratimin e linjave dhe të distancave të transportit rrethqytetës.”

3. Fjalja e dytë e pikës 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përlllogaritja e fondeve që prokurohen kryhet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të punonjësve arsimorë, që përfitojnë shërbim transporti, vetëm për ata punonjës arsimorë që udhëtojnë brenda linjave të transportit rrethqytetës, numrit të nxënësve që përfitojnë shërbimin e transportit dhe të tarifës/çmimit të biletës për linjat rrethqytetëse të transportit, të cilat subvencionohen, bazuar në shkronjën “b”, të nenit 10, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, sipas distancave dhe tarifave të miratuara me vendimin nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus”, duke shtuar, vetëm për nxënësit/fëmijët e arsimit të përgjithshëm, edhe 50 (pesëdhjetë) për qind mbi çmimin e biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.”

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. ZVAP-të, mbështetur në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, paguajnë çdo muaj shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të institucioneve publike, ose nëpërmjet shërbimit postar, vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, deri në dërgimin e kontratës së nënshkruar nga DRAP-ja me operatorët ekonomikë për realizimin e shërbimit të transportit.

ZVAP-të dhe ofruesit e arsimit profesional publik kryejnë pagesat vetëm për ditët e punës të



realizuar në fakt nga punonjësit arsimorë dhe ditët që nxënësit kanë ndjekur procesin mësimor, konfirmuar zyrtarisht nga drejtuesit e IAP-ve publike, në përputhje me planin mësimor vjetor të miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Paga për punonjësit arsimorë, të cilët janë të punësuar në IAP-të publike, si dhe nxënësit që ndjekin arsimin profesional publik, jashtë territorit të bashkisë së vendbanimit të tyre, në distancat, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, kryhet në bazë të vendimit nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus”, në llogaritë e tyre bankare, të prindit apo të kujdestarit ligjor, si dhe kjo kategori punonjësish e nxënësish nuk përfshihet në përlllogaritjen e fondit për procedurën e prokurimit publik, sipas pikës 2 të këtij vendimi.”.

6. Në pikën 6, fjalët “... sipas paragrafit 4.a), të pikës 4, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, për distancat, si më poshtë vijon: ... “ zëvendësohen me “... sipas shkronjës “a”, të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, për distancat, si më poshtë vijon: ... “.

7. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Punonjësit arsimorë, të cilët janë punësuar në IAP-të publike të arsimit të përgjithshëm, kur punojnë jashtë qendrës urbane, në distancë nga vendbanimi i tyre mbi 50 km, dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe përfitojnë kompensim mujor, sipas shkronjës “a”, të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”.

Punonjësit arsimorë, të cilët janë punësuar në IAP-të publike, në distancë nga vendbanimi mbi 50

km, të cilët nuk kthehen brenda ditës në vendbanim, që nuk përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit, sipas këtij vendimi, përfitojnë kompensim mujor, sipas shkronjës “b”, të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”.”.

8. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Për bashkitë, me të cilat ministria përgjegjëse për arsimin ka lidhur marrëveshje për kalimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar, sipas kohëzgjatjes së tyre, transporti për punonjësit arsimorë dhe fëmijët/nxënësit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, sigurohet nga bashkitë ku ndodhen institucionet arsimore parauniversitare, që shkojnë punonjësit arsimorë dhe fëmijët/nxënësit. Ministria përgjegjëse për arsimin transferon fondet e nevojshme te njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat përlllogariten mbi bazën e numrit të ditëve mësimore të planifikuara, të numrit të punonjësve arsimorë, të numrit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar dhe të çmimit mesatar të biletës, sipas distancave dhe tarifave të miratuara me vendimin nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus”. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar monitorojnë realizimin e procedurave nga bashkitë përkatëse dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin në çdo 4 muaj, si dhe në përfundim të vitit shkollor.

Përfundimisht, për vitin shkollor 2024–2025, njësitë e vetëqeverisjes vendore realizojnë procedurat ende të pakryera nga DRAP-të dhe ZVAP-të, sipas këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, ofruesit e arsimit profesional publik dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Belinda Balluku



## VENDIM

Nr. 240, datë 24.4.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË VENDIMIN NR. 730, DATË 20.10.2016,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR  
KUSHTET, KRITERET, TARIFAT,  
AFATET DHE PROCEDURËN PËR  
KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE  
AKOMODUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Paraqitja e aplikimeve përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”, si dhe kthimi i përgjigjeve për aplikimet nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, me vulë elektronike, hyn në fuqi pas ngritjes dhe funksionimit të plotë të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Turizmit. Deri në ngritjen dhe funksionimin e plotë të sistemit, paraqitja e aplikimeve, si dhe përgjigjet për aplikimet dërgohen sipas përcaktimeve në fuqi në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Në pikën 3, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.

3. Në rregulloren për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) kudo në përmbajtjen e rregullores, fjalët “kërkesa/kërkesën/kërkesës” dhe “kërkuesi/kërkuesit/kërkuesin” zëvendësohen përkatësisht me “aplikimi/aplikimin/aplikimit” dhe “aplikuesi/aplikuesit/aplikuesin”;

b) në pikën 1, të nenit 1, fjalët “... dhe kategorizimin ...” hiqen;

c) në pikën 2, të nenit 3, bëhen ndryshimet e

mëposhtme:

i. shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) “Aplikim nga subjekti ose sipërmarrësi turistik”, është aplikimi *on-line*, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” për klasifikim, riklasifikim, rinovim të vlerësimit të strukturës akomoduese, si dhe ndryshim të të dhënave në certifikatë.”.

ii. shkronja “c/1” shfuqizohet;

ç) titulli i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KLASIFIKIMI I STRUKTURAVE AKOMODUESE”.

d) neni 4 shfuqizohet;

dh) në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

i. pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, pajiset me certifikatë klasifikimi për ushtrimin e këtij aktiviteti.”.

ii. pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Komisioni klasifikon çdo strukturë akomoduese, mbështetur në kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë rregullore dhe në aneksin nr. 1 “Kushtet dhe kriteret e klasifikimit”, bashkëlidhur këtij vendimi.”;

e) pika 1, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë strukturë akomoduese, duhet të paraqesë nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” aplikimin për pajisjen me certifikatë klasifikimi, duke plotësuar formularin elektronik.”;

ë) në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

i. në pikat 2 dhe 3, pas fjalëve “... ministria njofton kërkuesin ...” shtohen “... elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” ...”;

ii. në pikën 7, fjalët “... me shkrim ...” zëvendësohen me “... elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” ...”;

f) në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

i. në pikën 2, fjalët “... një njoftim me shkrim ...” zëvendësohen me “... njoftimin elektronikisht, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” ...”;

ii. në shkronjën “a”, të pikës 3, pas fjalëve “Lëshimin e certifikatës së klasifikimit ...” shtohen “... me vulë elektronike, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*” ...”;

g) në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

i. pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga



marrja e vendimit për përcaktimin e nivelit të klasifikimit, përgatit certifikatën e klasifikimit me nënshkrim elektronik/dhe me vulë elektronike dhe ia dërgon aplikuesit nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”.”.

ii. fjalia hyrëse e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Certifikata e klasifikimit nënshkruhet elektronikisht nga ministri ose personi i autorizuar prej tij dhe përmban:”.

iii. pika 3 shfuqizohet.

gj) pika 1, e nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Sipërmarrësi turistik, i cili zotëron një certifikatë klasifikimi, në rastet kur kanë ndodhur ndryshime në të dhënat e paraqitura për marrjen e saj ose çdo ndryshim, që mund të ndikojë në klasifikimin e strukturës akomoduese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga ndodhja e tyre, aplikon në portalin qeveritar “*e-Albania*”.”.

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Belinda Balluku**



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

